



AUTORITETI I  
MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE



**REVISTË  
AUTORITETI  
I MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE**

**TIRANË, JANAR 2016**

# PËRMBAJTJA



## VEPRIMTARITË E AUTORITETIT

FOKUSI - RREGULLATORI DHE MBIKQYRJA	5
FOKUSI - NDIKIMI NË VETËRREGULLIMIN E TREGUT AUDIOVIZIV	8
FOKUSI - NGRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT TË AUTORITETIT	14
FOKUSI - PARTNERITETI NDËRKOMBËTAR	18

## DIGJITALIZIMI

VENDI PËRGATITET PËR EPOKEN E RE TË TRANSMETIMEVE	23
---	----

## KONFERENCA NDERKOMBËTARE SHKENCORE

DIGJITALIZIMI I TRANSMETIMEVE TOKËSORE: SFIDA, PARADOKSE, SHPRESA	27
---	----

## INTERVISTË ME AKADEMIKUN PROF. DR. ARTAN FUGA

31

## RETROSPEKTIVË

HISTORIKU I KRIJIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË AMA-S	37
--	----



**REVISTË  
AUTORITETI  
I MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE**  
TIRANË, JANAR 2016



Numri i parë i revistës së AMA-s vjen pas një viti të frytshëm dhe pune intensive të Autoritetit. Rol kryesor në realizimin e këtyre arritjeve kanë luajtur të gjithë aktorët, organizmat ndërkombëtarë dhe vendas por më së shumti puna dhe pasioni i gazetarëve, autorëve, teknikienëve, dhe pedagogëve, e për të mos lënë pa përmendur, dëshirën dhe investimin e AMA-s dhe stafit të saj mbështetës.

Vitin që kaloi AMA u investua në krijimin e praktikave të mira duke konsideruar primar rolin e saj të përçimit të vlerave dhe standardeve më të mira në tregun mediatik vendas.

AMA është e përfshirë në sfida të rëndësishme si, digjitalizimi i transmetimeve, zbatimi i kodit të etikës në mediat audiovizive dhe lufta kundër piraterisë. Këto sfida janë duke konsoliduar lirinë e medias, cilësinë e përmbajtjes dhe informimit të publikut, pluralizmin në tregun e mediave audiovizive dhe konkurrencën e ndershme.

Zbatueshmëria e ligjit do të krijojë një mjedis të sigurt për zhvillimin e mediave audiovizive, ndaj AMA ka shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e saj për garantimin e respektimit të këtij kuadri pavarësisht se jemi të vetëdijshëm që konsolidimi i këtij tregu drejt shinave të ligjit është një proces në vazhdim.

Viti që kaloi e vendosi AMA-n në tablonë e fushës së medias dhe e ka bërë avokate të fortë të medias së lirë, të pavarur dhe objektive. Por, ajo që ne duam të arrijmë është një media audiovizive jo diskriminuese, gjithëpërfshirëse, kulturore, informative dhe edukuese.

Ky rol, në fakt, nuk i përket vetëm AMA-s por gjithë ansamblit të njerëzve të medias, ku etika, kultura mediatike, cilësia e përmbajtjes, përbëjnë objektivin tonë të përbashkët duke mos lënë pa përmendur këtu edhe rregullimin e statusit të gazetarit.

Në rolin e saj nxitës, AMA ka iniciuar dialogun me të gjithë aktorët e interesuar në rregullimin dhe zhvillimin e këtij tregu, duke ndërmarrë takime të vazhdueshme me profesionistët e medias në vendosje të urave të reja bashkëpunimi, faktorë suksesi në të ardhmen.

Me dëshirën e konkretizimit të këtij misioni kaq të rëndësishëm të AMA-s dhe aktorëve mediatik në shoqëri, ju përshëndes!

Gentian Sala  
Kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive



# VERPRIMTARITË E AUTORITETIT



Takimi me operatorët radiofonikë



# FOKUSI - RREGULLATORI & MBIKQYRJA

## ZBATUESHMËRIA E LIGJIT

Në forcimin e rolit të tij rregullator Autoriteti ka përqendruar vëmendjen e tij në gjetjen e mënyrave efikase që rrisin zbatueshmërinë e ligjit nga ana e operatorëve audiovizive. Hapja e një dialogu transparent dhe konstruktiv me OSHMA-të me fokus bashkëpunimin e të gjithë aktorëve të interesuar në ngritjen e një mjedisi rregullator ku garantohet konkurrenca dhe veprimtaria e lirë ka qenë një nga metodat efikase të përdorura nga Autoriteti në rritje të zbatueshmërisë së ligjit. Ndër takimet e kryera përgjatë gjithë vitit më të rëndësishme mund të veçohen:

- Takimi me ofruesit e shërbimeve mediatik për ripërsëritjen e programeve

audiovizive të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor, i zhvilluar me pjesëmarrjen e të gjithë subjekteve të licencuar nga AMA, në të gjithë territorin e vendit ku qëllimi i takimit ishte domosdoshmëria e zbatimit të ligjshmërisë, njohja dhe diskutimi i problematikave që hasin këta subjekte, marrëdhëniet institucionale me AMA-n dhe zbatimi i kontratave mbështetur në legjislacionin në fuqi.

- Takimi me operatorët televizivë lokalë dhe rajonalë në qershor 2015 me fokus kryesor problematikën e mbështetjes së operatorëve në rrjetin e TVSH-së, si dhe përlogaritjen e tarifave përkatëse gjatë procesit të digjitalizimit. Kryetari i AMA-s, theksoi vëmendjen që ka ky institucion për të pasur një proces transparent dhe të bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në strategjinë kombëtare të kalimit të



Takimi me operatorët televizivë rajonalë



transmetimeve nga analogu në numerik, duke sjellë një produkt më të mirë për publikun dhe me kosto sa më të ulët.

- Takimi me subjektet radiofonike të licencuar që transmetojnë në Shqipëri, në korrik 2015 ku agjenda e diskutimit përfshinte dinamikat e tregut të transmetimeve audio në vendin tonë, problemet dhe trendet e zhvillimit, kuadrin legjislativ dhe aspekte nga performanca e radiostacioneve kombëtare, rajonale dhe lokale. AMA kërkoi nga subjektet përmbushjen me përpikmëri të ligjit për mediat audiovizive si respektimin e gjuhës shqipe, respektimin e të drejtave të autorit, detyrimin e subjekteve audio për të pasur një strukturë të mirëfilltë programore në përputhje me licencën që ato marrin.



## RESPEKTIMI I TË DREJTAVE THEMELORE NË USHTRIMIN E TË DREJTËS SË SHPREHJES

AMA në garantimin e një mjedisi, të favorshëm në ushtrimin e të drejtës së shprehjes, dhe duke respektuar të drejtat themelore të njeriut, ka monitoruar vazhdimisht ndalimin e përmbajtjeve që nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo lloj tjetër diskriminimi, dhe ka reaguar institucionalisht dhe publikisht për adresimin e rasteve që kanë kërkuar zgjidhje nga aktorë të tjerë duke përmendur ndër të tjera rastet të cilat kanë tërhequr dhe më shumë vëmendjen e opinionit publik si:

- Dënimin e rastit dhe adresimin në organet kompetente për ngjarjen e ndodhur ndaj dy gazetarëve në dt. 19 maj 2015, duke u pozicionuar në mbrojtje dhe në mbështetje të gazetarëve dhe lirisë së shprehjes, me anë të deklaratave të bëra.

- Marrjen e masave administrative dhe reagimin publik të Autoritetit ndaj cenimit të parimeve themelore të ligjit në rastin e emisionit “Zonë e Lirë” të dt. 8-9 Maj 2015 të transmetuar në një televizion kombëtar ku ishin identifikuar elemente që nxisnin intolerancën midis shtetasve, duke nxitur dhe justifikuar dhunën.



- Takimi me komunitetet dhe përfaqësuesit e bashkësive fetare i organizuar nga Kryetari i Autoritetit në nëntor 2015 në kuadër të transparencës dhe përfshirjes së aktorëve të interesuar në këshillimet publike gjatë hartimit të projekt rregulloreve për OSHMA-të.

## NDËSHKIMI I PIRATERISË DHE GARANTIMI I TË DREJTAVE TË AUTORIT

AMA, në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe përmbushjes së detyrave ligjore për mbikëqyrjen e operatorëve audio dhe audiovizive, ka ndërmarrë gjatë gjithë vitit aksione inspektimi

gjithëpërfshirëse kundër ushtrimit të veprimtarisë audiovizive në mënyrë të kundërligjshme, pa autorizim nga AMA dhe në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Aksionet janë shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe janë kryer në bashkëpunim të plotë me Policinë e Shtetit, si dhe me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për rastet kur subjektet, ishin mbështetur në mënyrë të paligjshme në shtyllat elektrike.

Nga inspektimet e kryera, për rreth 23 subjekte të identifikuar duke zhvilluar veprimtari audiovizive të pa autorizuar, AMA ka proceduar me masat administrative ndëshkuese për dënimin me gjobë dhe, në bazë të ligjit dhe në disa



raste ka vijuar me bllokimin e pajisjeve, inventarizimin dhe sekuestrimin e tyre.

Njëkohësisht, ndaj disa prej shkelësve të ligjit që shfaqën rezistencë në zbatueshmërinë e ligjit është paraqitur kallëzim penal përpara organeve përkatëse. AMA garanton ndërmarrjen e aksioneve të tilla dhe përgjatë vitit në vazhdim duke ushtruar funksionet e tij mbikëqyrës për ndëshkimin e piraterisë dhe mbrojtjes së të drejtave të autorit.

# FOKUSI - NDIKIMI NË VETËRREGULLIMIN E TREGUT AUDIOVIZIV

AMA nëpërmjet proceseve të informimit, koordinimit dhe edukimit të tregut në bashkëpunim me aktorët e tjerë synon të nxisë realizimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive në Shqipëri dhe që është i përgjegjshëm për nevojat e dëgjuesve dhe shikuesve duke siguruar shumëllojshmëri dhe cilësi të lartë të programeve.

## TRAJNIMI “PËRMIRËSIMI I RAPORTIMIT TË ÇËSHTJEVE TË FËMIJËVE NË MEDIAN AUDIOVIZIVE”

Më 16 dhe 17 dhjetor 2015 një grup prej 20 gazetarësh dhe redaktorësh që punojnë në mediat audiovizive publike dhe private zhvilluan një modul trajnimi, si pjesë e projektit “Përmirësimi i raportimit të çështjeve të fëmijëve në median audiovizive”, organizuar nga Instituti Shqiptar i Medias në Tiranë (ISHM).

Mbrojtja e të miturve në ekran është një nga temat më të rëndësishme në



Trajnimi “Përmirësimi i raportimit të çështjeve të fëmijëve në median audiovizive”

performancën e subjekteve audiovizive dhe objekt diskutimi në radhët e komunitetit të medias në përgjithësi. “Ndaj dhe këtë akord të parë të përbashkët me AMA-n vendosëm ta përqendrojmë në këtë aspekt, për të cilin kemi evidentuar mjaft probleme profesionale”, u shpreh Remzi Lani, drejtor i ISHM-së. Sipas tij,

gjatë vitit 2016 do të ketë të tjera module trajnimi, në të cilat do të përfshihen dhe reporterë nga stacionet televizive lokale dhe rajonale të vendit. Ekspertët e angazhuar në këtë modul, në seanca të veçanta diskutuan me pjesëmarrësit tema që lidhen me kuadrin legjislativ dhe rregullator në transmetimet audiovizive si:

- dispozitat kushtetuese dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- formatet e raportimit;
- burimet dhe teknikat e intervistimit;
- specifikat e pasqyrit të problematikës së fëmijëve në mediat audiovizive;
- puna në redaksi dhe njohuritë që gazetari social duhet të zotërojë për një pasqyrim sa më të plotë dhe frytdhënës;
- njohja e gazetarëve me Kodin e Transmetimit të AMA-s;
- roli dhe ndikimi i Transmetuesit Publik;
- emisionet për fëmijë dhe të rinjtë si mënyrë të shprehuri;
- rastet studimore të marra nga media audiovizive shqiptare, lidhur me etikën dhe fëmijët.

“AMA në angazhimin e vet nuk synon vetëm procesin e monitorimit për të verifikuar përputhshmërinë me ligjin dhe Kodin e Transmetimit të përmbajtjeve të transmetuara. Gjatë vitit 2015 jemi investuar dhe tek partneriteti me institucione dhe organizata që punojnë në fushën e mediave, sidomos në mediat audiovizive. Jemi në favor të nxitjes së redaksive për produkte cilësore dhe të shumëllojshme, pasi kjo është pritshmëria e audiencës,”

deklaroi gjatë ceremonisë së shpërndarjes së certifikatave,

**z. Gentian Sala**, kryetar i AMA-s.





## NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES PËR PRAKTIKAT STUDENTORE MIDIS AMA-S DHE DEPARTAMENTIT TË GAZETARISË NË SHQIPËRI DHE KOSOVË

AMA nënshkroi marrëveshjen për realizimin e praktikave mësimore, me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, të Universitetit të Tiranës dhe me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, të Universitetit “Hasan Prishtina”, në Kosovë. AMA do t’u mundësojë studentëve, të cilët janë diplomuar apo janë në proces diplomimi, një praktikë mësimore, e cila ka për qëllim të sigurojë një këndvështrim praktik si dhe rritje profesionale të studentëve të cilët, falë formimit akademik dhe më pas njohjes me praktikën do të rrisin mundësitë për t’u punësuar më shpejt dhe për të qenë më të përgatitur për punën apo për interesat e tyre në punë kërkimore.



Nënshkrimi i marrëveshjes për praktikat studentore midis AMA-s dhe Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, në Universitetin e Tiranës.



Nënshkrimi i marrëveshjes për praktikat studentore midis AMA-s dhe Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, në Universitetin “Hasan Prishtina”, Kosovë.

## NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

Në fillim të marsit 2015, u nënshkrua zyrtarisht marrëveshja e bashkëpunimit për transmetimet audiovizive mes AMA-s dhe Komisionit të Pavarur të Medias në Republikën e Kosovës (KPM). Nënshkrimi i marrëveshjes bëri të mundur që Shqipëria dhe Kosova të bashkëpunojnë për menaxhimin e frekuencave, rregullimin e çështjeve për përmbajtjen e programeve, shkëmbimin e përvojës për hartimin dhe zbatimin e kuadrit rregullator për komunikimet audiovizive, mbrojtjen e së drejtës së transmetimit dhe të drejtës së autorit si dhe shkëmbimin e informacionit për operatorë të ndryshëm që transmetojnë në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës. Veprimtaritë e përbashkëta, këshillimet mes palëve etj., do të realizohen nëpërmjet grupeve të përbashkëta të punës.



## AMA DHE KËSHILLI I MEDIAS LIDHIN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR PËRDORIMIN E ARKIVIT TË AMA-S

AMA në kuadrin e ndërtimit të një marrëdhënieje bashkëpunimi me gazetarët, median dhe gjithë tregun audioviziv në Shqipëri, si dhe me qëllim zhvillimin e një medie të pavarur, pluraliste dhe profesionale, së bashku me Këshillin e Medias nënshkruan në muajin tetor marrëveshjen e bashkëpunimit midis tyre. Kjo marrëveshje është në funksion të ndërtimit të urave lidhëse midis këtyre dy organizmave dhe ka si synim final pluralizmin e medias, demokracinë e saj dhe ruajtjen e standardit të mediave audiovizive informative, kulturore dhe promovuese të vlerave.

Kjo marrëveshje do të thjeshtojë shkëmbimin e informacionit mes palëve, do t’i hapë rrugë publikimeve si edhe do të forcojë rolin e gazetarit në tregun e sotëm audioviziv.



Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për transmetimet audiovizive mes AMA-s dhe Komisionit të Pavarur të Medias në Republikën e Kosovës





Z. Sala theksoi se të gjithë e dimë, që media dhe në veçanti televizioni është një ndër faktorët kryesorë që ndikon në formimin e qytetarit. Ndaj bie dyfish përgjegjësia ndaj organizmave për të ndërtuar një media ku të respektohen parimet e etikës, liria e shprehjes, si edhe pluralizmit.



## AMA DHE KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE BASHKËPUNOJNË PËR ZBATIMIN E AKTEVE LIGJORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË MEDIA

Në muajin shtator Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Z. Besnik Dervishi dhe Kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive Z. Gentian Sala, në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit për ruajtjen e të dhënave personale gjatë raportimeve

nga media, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit. Ky dokument, parashikon ndër të tjera nxitjen dhe sensibilizimin e opinionit publik me qëllim rritjen e ndjeshmërisë për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e mediave audiovizive, hartimin dhe rishikimin e programeve të transparencës, hartimin e kodit/kodeve të etikës së mediave audiovizive si dhe bashkëpunime ndërmjet dy institucioneve për zbatimin e akteve ligjore në fushën e të drejtës për informim.



AMA dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nënshkruajnë marrëveshje për zbatimin e akteve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale në media



AMA dhe Këshilli i Medias lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përdorimin e arkivit të AMA-s



# FOKUSI - NGRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT TË AUTORITETIT

AMA, NUK KA NJË QASJE TË RE VETËM NDAJ OSHMA-VE, MEDIAVE DHE PALËVE TË TJERA ME TË CILAT AI KOMUNIKON DHE KA MARRËDHËNIE INSTITUCIONALE, POR AMA ËSHTË DUKE PUNUAR EDHE NË FORCIMIN E KAPACITETEVE TË SAJ NJERËZORE. NË FUNKSION TË RRITJES SË CILËSISË SË PUNËS, AMA INKURAJON DHE MERR PËRSIPËR QË PUNONJËSIT E SAJ TË PËRMIRËSOJNË DHE TË ZHVILLOJNË AFTËSITË E TYRE PROFESIONALE TË LIDHURA ME PUNËN.



## AMA ORGANIZON VIZITËN STUDIMORE NË AUTORITETIN HOLANDEZ TË MEDIAVE

Në muajin maj të këtij viti një delegacion nga AMA, mbështetur nga Këshilli i Evropës organizoi një vizitë studimore pranë Autoritetit Holandez të Mediave (Commissariaatvoor de Media). Qëllimi i vizitës studimore ishte, përvetësimi i eksperiencave më të mira në fushën e

transmetimeve audiovizive, si dhe për të parë shembullin e funksionimit të Autoritetit Rregullator Holandez duke u njohur me këto institucione. Në kuadër të reformave në fushën e digjitalizimit, që është një nga sfidat që e pret AMA-n në të ardhmen e afërt, trajnimi dhe njohja e administratës së AMA-s me standardet dhe praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e medias elektronike, është vlerë e shtuar në këtë drejtim.



AMA viziton Autoritetin Holandez të Mediave (Commissariaatvoor de Media), 2015

## TRAJNIMI “SJELLJA INSTITUCIONALE DHE MOTIVIMI”

Lektorë i këtij trajnimi ishte Dr. Hysamendin Feraj, Profesor i Shkencave Politike.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë organizoi në muajin shtator të vitit 2015, një trajnim për stafin e AMA-s, në qytetin e Korçës.

Ky trajnim kishte si tematikë ‘Sjelljen Institucionale dhe Motivimin’, këto të marra në kontekstin dhe kushtet e stafit të AMA-s. Sjellja Institucionale është një fushë e cila shqyrton dhe merr në analizë sjelljen e individëve, grupeve apo strukturave institucionale në kuadrin e pozicionit në strukturën institucionale. Fokus i kësaj fushe është përmirësimi i rendimentit të punës, mjedisit dhe kushteve të punës, marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe mes kolegëve.









# FOKUSI - PARTNERITETI NDËRKOMBËTAR



AMA prej një viti tashmë ka filluar një bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e rajonit dhe më gjerë. AMA në këtë proces është duke u investuar për të nxitur frymën e partneritetit me institucione e organizata brenda dhe jashtë vendit të cilat operojnë në fushën e tregut audioviziv. Këto shkëmbime kanë ndikuar që rregulloret apo aktet nënligjore të hartuara dhe të nxjerra nga AMA të kenë edhe konsulencë nga Autoritete të rajonit dhe më gjerë.



## AMA NË MBLEDHJEN E 41-TË TË EPRA-S NË BERNË

Në datat 14-15 Maj 2015, u zhvillua, në Bernë të Zvicrës, takimi i 41-të i Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatorë (EPRA), ku ishte pjesëmarrës dhe delegacioni nga AMA.

Çështjet kryesore që u diskutuan lidheshin me sigurimin e një ekosistemi të qëndrueshëm në përmbajtjen e mediave Evropiane, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë rreth aspekteve të konsumit dhe shpërndarjes, si dhe mbi alternativat aktuale që kanë për qëllim monitorimin e pluralizmit të mediave.

Gjatë takimit u krijuan grupe pune me autoritetet rregullatorë të vendeve të ndryshme pjesëmarrëse, në mënyrë që të shkëmbejnë eksperiencat e tyre duke u fokusuar në:

- përcaktimin e fushëveprimit të shërbimit publik dhe çështjeve financiare gjatë epokës digjitale;
- tendencat dhe sfidat në komunikimet komerciale audiovizive;
- rregullatorët dhe mënyrat kërkimore me fokusin në çështjet që lidhen me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave



AMA në mbledhjen e 41-të të EPRA-s në Bernë

për të siguruar një “dëshmi-bazë” në mënyrë që këta rregullatorë të përmbushin qëllimet e tyre.

Në kuadër të prioritetit në fushën e programacionit, AMA mori pjesë në grupin e dytë të punës duke marrë eksperiencat e duhura në fushën e komunikimeve tregtare audiovizive.

## AMA MERR PJESË NË FORUMIN E 6-TË TË AUTORITETEVE AUDIOVIZIVE RREGULLATORË TË VENDEVE TË DETIT TË ZI

Gjatë muajit nëntor AMA u përfaqësua në aktivitetin e BRAF-it (Autoritetet Audiovizive Rregullatorë të vendeve të Detit të Zi). Forumi u zhvillua në Yerevan, Armeni. Temat kryesore të takimit ishin:

- rregullimi i komunikimeve tregtare në transmetimet audiovizive;
- aspekte të legjislacionit;
- zbatimi i parimeve themelore në transmetimin e reklamave;
- teleshitjet;
- sponsorizimet;
- vendosja e produktit;
- llojet e programeve ku ndalohen komunikimet tregtare, etj.

## AMA NË MBLEDHJEN E 42-TË TË EPRA-S NË NUREMBERG

Në mbledhjen e fundit të EPRA-s që u mbajt në Nuremberg, u diskutua “Agjenda digjitale” e vendeve anëtare të saj, e cila u prezantua nga Marcel Boulogne, përfaqësues i Komisionit Evropian. Takimi kishte karakter interaktiv, ku pyetjet, krahasimi i situatave dhe problematikave të veçanta u diskutuan në grupe pune.

AMA ishte pjesë e grupit të punës: “Komunikimi audioviziv me natyrë tregtare, trendet dhe sfidat” ku u diskutua dhe u debatua mbi reklamën e fshehur. Përfaqësuesit e AMA-s në grupin e punës, diskutuan edhe rastin e Shqipërisë, si një vend ku reklama e fshehur është ende problematikë kryesore. Përfaqësuesit e AMA-s diskutuan me grupin e punës raste konkrete të reklamës së fshehur në emisione televizive, edicione lajmesh, apo klipe edhe produksione të tjera televizive. Diskutimi i tyre solli ide për reduktimin dhe parandalimin e këtij fenomeni.



AMA në mbledhjen e 42-të të EPRA-s në Nuremberg



## AMA MERR PJESË NË KONFERENCËN BOTËRORE TË RADIOKOMUNIKIMEVE (WRC-15)

AMA dërgoi përfaqësinë e saj në mbledhjen e radhës së ITU-së (Agjencia e specializuar e Kombeve të Bashkuara për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit) në Gjenevë.

Përfaqësuesit e AMA-s ndoqën me përparësi takimet e organizuara nga grupi i punës 4C1 i ngritur nga ITU për të studiuar përdorimin e brezit UHF (Ultra High Frequency).

Gjithashtu, morën pjesë në takimet e organizuara nga CEPT-i (Konferenca Europiane e Administratave të Post Telekomunikacioneve), organi koordinues për vendimmarrjet e vendeve të BE-së, si dhe ndoqën seancat plenare në të cilat bëhej miratimi i akteve dhe rezolutave për të cilat binin dakord të gjitha shtetet pjesëmarrëse.

Konferenca analizoi një numër të madh çështjesh të rëndësishme dhe të ndjeshme, duke filluar nga komunikimet broadband, sistemet satelitore, komunikimet në raste emergjencash dhe ndihmave në raste fatkeqësish, komunikimet detare dhe aeronautike, monitorimin e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, shërbimet e radiokomunikimit për publikun në lidhje me shëndetin, informimin, edukimin, sigurinë, etj.



AMA në mbledhjen e Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatorë, Tetor 2015, Split, Kroaci

## AMA NË MBLEDHJEN E RRJETIT MESDHTAR TË AUTORITETEVE RREGULLATORË

AMA mori pjesë në mbledhjen më të fundit të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore (MNRA) në tetor, në Split.

Në takim u diskutuan problematika të televizionit në kohët e sotme, në shtetet që ishin pjesëmarrëse në mbledhje. Diskriminimi gjinor dhe sjellja në debat e rasteve studimore nga grupet e punës sollën në vëmendje problematikat e përbashkëta.

Emigracioni, të drejtat e njeriut dhe prezantimi i tij në media, u ngritën si problematika dhe u prezantuan nga Autoriteti katalonjas.

Pasqyrimi i pluralizmit politik në media gjatë periudhës së zgjedhjeve ishte po ashtu temë e agjendës së takimit. Trajtimi i këtyre çështjeve në një komunitet të tillë ekspertësh është për AMA-n një ndihmë e madhe në përsosjen e punës së saj.



# DIGJITALIZIMI

*Digjitalizimi është një zhvillim i ri, një epokë e re e transmetimeve televizive në gjithë botën. Së shpejti, pritet që edhe në Shqipëri, transmetimet analoge të ndërpriten dhe publiku përmes ekranit të televizorit do të ketë mundësi të shohë një gamë më të gjerë shërbimesh bazuar në teknologjinë digjitale. Teknologjia digjitale transformon mënyrën sesi publiku do të shohë tashmë televizor. Ajo do të sjellë zgjedhje më të mira, cilësi më të mirë, më shumë programe dhe më shumë shërbime të reja.*

## VENDI PËRGATITET PËR EPOKËN E RE TË TRANSMETIMEVE

Me transmetimet digjitale përfitimet e publikut janë të drejtpërdrejta, konkretisht:

- **Më shumë kanale** në dispozicion të publikut: Në transmetimin analog një frekuencë përçonte një program të vetëm, kurse në transmetimin digjital një frekuencë e vetme përçon deri në tetë programe. Kjo do të thotë më shumë mundësi e më shumë zgjedhje, më shumë informacion, më shumë kulturë, argëtim dhe edukim përmes ekranit.
- **Më shumë shërbime dhe aplikime:** Do të ketë shumë shërbime dhe aplikime ndërvepruese të mbështetura në teknologjitë e fundit. Platformat e reja u lejojnë shikuesve të shohin programin e dëshiruar në çdo kohë. Përveç kësaj, shikuesit mund të dëgjojnë kanale radio dhe mund të hyjnë në internet për të aksesuar një sërë aplikacionesh nëpërmjet televizorit të tyre.
- **Cilësi më të lartë të figurës dhe zërit:** Teknika digjitale ofron përmirësim të ndjeshëm të sinjalit të transmetuar: figurë të qartë dhe të pastër, pa hije, rezolucion të lartë, zë të kthjellët, pa zhurma të tepërta, pa interferenca.
- **Të gjitha platformat numerike në një dekoder:** Tashmë nuk është e nevojshme të blini dekoder për



çdo platformë numerike. Avantazhi i teknologjisë digjitale lejon që ju të përdorni një dekoder për të parë programet e ofruara nga platformat e ndryshme numerike.

- **Ndërveprim të drejtpërdrejtë me televizorin:** Ju mund të ndërveproni me programet përmes telekomandës, me opsione praktike, të dobishme e të shumëllojshme. Televizioni digjital i lejon përdoruesit të aksesojnë më shumë informacion duke hyrë në menutë përkatëse dhe duke bashkëvepruar me televizorin.
- **Më shumë mbrojtje për fëmijët tuaj:** Prindërit apo kujdestarët kanë mundësi të kontrollojnë atë çfarë shikojnë fëmijët e tyre në televizor nëpërmjet klasifikimit të programeve ose duke zgjedhur të gjithë kanalet televizive.



## SITUATA AKTUALE DHE ANGAZHIMET E AMA-S NË PROCES

Shqipëria ende nuk e ka përfunduar procesin e digjitalizimit (ndër vendet e rajonit janë edhe Kosova e Bosnjë-Hercegovina). Ky proces ka qenë një sfidë e vështirë edhe për shtetet që e kanë implementuar atë, pasi ky proces kërkon një koordinim të mirë të të gjithë aktorëve që marrin pjesë në të, qeverisë, rregullatorëve, operatorëve, shoqatave të operatorëve, industrisë, etj.

Me rëndësi në këtë proces është ndërtimi i rrjeteve numerike të operatorit publik shqiptar, RTSH-së. Aktualisht RTSH-ja është në fazën e implementimit të dy rrjeteve kombëtare numerike. Ndërkohë AMA ka çelur garën për licencimin e operatorëve privatë kombëtarë dhe është në procesin e vendimmarrjes. Ndërtimi i rrjeteve numerike kombëtare është me rëndësi pasi në këto rrjete do të mbështeten edhe operatorët ekzistues lokalë apo rajonalë, duke siguruar kështu vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve televizive nga këta operatorë. Transmetimi i programeve të tyre do të jetë i hapur (pa pagesë) edhe pasi ato të mbështeten në rrjetet numerike.

AMA ka organizuar dhe do të vijojë të organizojë konferenca dhe seminare me aktorët e tregut audioviziv deri në përfundim të procesit të digjitalizimit, në kuadër të informimit të tyre mbi legjislacionin dhe mënyrat e detajuara të kalimit në transmetimet numerike. AMA ka në fokus organizimin dhe

koordinimin e fushatës për informimin e publikut, hartimin e broshurave dhe manualeve të cilat do t'u vijnë në ndihmë, përdoruesve të shërbimit të ri. Gjithashtu AMA është duke krijuar strukturën e Call Center-it e cila do të ofrojë ndihmë teknike për publikun e gjerë.

Publiku do të jetë i informuar hap pas hapi mbi procesin e digjitalizimit nëpërmjet faqes zyrtare të AMA-s, spoteve publicitare, emisioneve televizive dhe fletëpalosjeve që AMA ka përgatitur.

Përgatiti: **Elkeda Domi**  
*Përgjegjëse e Sektorit të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave*





# KONFERENCA NDËRKOMBËTARE SHKENCORE

“

Në muajin nëntor AMA ka zhvilluar një sërë aktivitete që kanë rritur përmirësimin e veprimtarisë së vetë Autoritetit dhe bashkëpunimit të tij me aktorë të medias si dhe palët e interesuara.

Një nga sfidat më të rëndësishme që ka AMA, është procesi i kalimit të transmetimeve analoge në ato numerike. AMA është përgjegjëse për administrimin e hallkave të rëndësishme të këtij procesi, si licencimin dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik për ndërtimin e rrjeteve numerike të transmetuesit publik, licencimin e operatorëve privatë kombëtarë, rajonalë e lokalë dhe kalimin në transmetimet numerike të të gjithë operatorëve privatë lokalë.

”

## DIGJITALIZIMI I TRANSMETIMEVE TOKËSORE: SFIDA, PARADOKSE, SHPRESA



Konferenca Ndërkombëtare Shkencore: “Digjitalizimi i transmetimeve tokësore: sfida, paradokse, shpresa”

Në muajin nëntor AMA mbështeti Konferencën Ndërkombëtare Shkencore: “Digjitalizimi i transmetimeve tokësore: sfida, paradokse, shpresa”, të organizuar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit. Ky aktivitet ndihmoi për të lidhur bashkë komunitetin e kërkuesve shkencorë, ekspertëve, drejtuesve të institucioneve, doktorantëve, pedagogëve dhe stafit të AMA-s. Pjesëmarrës në konferencë ishin edhe të ftuar nga Franca, Turqia dhe Italia, si: z. Philippe Levrier, ekspert me një eksperiencë 40 vjeçare në media, transmetim dhe telekomunikacion, zj. Mine Gencil Bek nga Universiteti i Ankarasë, eksperte në fushën e komunikimit në Bashkimin Evropian dhe në Turqi si dhe z. Augusto Preta, ekspert i Televizionit Digjital. Të ftuarit nga jashtë vendit sollën eksperiencën e tyre për kalimet në transmetimet digjitale, dhe

bënë një panoramë të shkurtër sesi ky proces ka ndodhur në vendin e tyre.

Kryetari i Autoritetit Z. Gentian Sala diskutoi mbi rolin e AMA-s në fuqizimin e hapësirës së bashkëpunimit të aktorëve publikë. Ky bashkëpunim do të ndihmojë në konsolidimin e mendimit intelektual dhe ekspertizës profesionale në fushën e digjitalizimit. Ai e vuri theksin në fjalën e tij se AMA është e vetëdijshme për rolin e saj në publik dhe është tërësisht e fokusuar që ta shtrijë edhe ta zgjerojë këtë rol. Hapësira publike në median shqiptare duhet të jetë me të vërtetë publike dhe e pacenuar.

Ndërsa Akademiku, Prof. Dr. Artan Fuga, në kumtesën e tij “Konvergimi në digjitalizimin dhe pasojat kundërthënëse të tij” vuri në dukje se kanalet televizive ndodhen sot përpara nevojës për



strukturim të thellë. Përpara tyre çështja nuk shtrohet nëse duan apo jo të investojnë drejt transmetimeve tokësore digjitale, por edhe të dinë se nëse nuk e bëjnë këtë hap, në kushtet e tregut të hapur, do të konkurrohen fort nga televizioni jolinear numerik që e anashkalon kanalin televiziv klasik si të tillë. Strukturimi përfshin të gjitha fazat e prodhimit televiziv, konceptimin, prodhimin, platformat e transmetimit si edhe formulat financiare që aktualisht kanë hyrë në krizë.

“Transmetuesi publik deri tani është marrë vetëm me çështjet teknike dhe teknologjike dhe ka neglizhuar përbajtjen. Ai po ndërton një platformë të veçantë që do të ketë minimalisht 12 programe gjeneraliste dhe të tematizuara por ende askush nuk e di se çfarë do të transmetohet në 12 kanalet” tha në kumtesën e tij Drejtori i Programeve pranë AMA-s, pedagogu dhe gazetari me përvojë Arben Muka.

Tema të tjera të rëndësishme që u trajtuan nga pedagogët e gazetarisë ishin: tiparet e tregut mediatic digjital, efektet e digjitalizimit në tregun e reklamës, shmangia e monopoleve në fushën e mediave audiovizive, sfidat e rregullimit të hapësirave të transmetimeve televizive digjitale në kushtet e aksesueshmërisë së lirë në internet, digjitalizimi i transmetimeve televizive përkundër komunikimit në web, etj.

Nga kjo konferencë do të dalë edhe një botim i cili do të përmbledhë të gjitha kumtesat të cilat tashmë janë trashëgimi shkencore e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit por edhe të AMA-s.





# INTERVISTË ME AKADEMIKUN PROF. DR. ARTAN FUGA

“NË PEIZAZHIN „MEDIATIK  
PROBLEMET JANË POR,  
PA DASHUR TA PIKTUROJ ME  
NGJYRA ROZË, JA VLEN TË  
TREGOHET SE DHE ARRITJE KA”

## 1. Prof. Fuga, cili është mendimi juaj për median audio dhe audiovizive, sot në Shqipëri?

Sado kritika t'i bëhen medias, sado mangësi të ketë ajo, marrë në përgjithësi, përbën një sipërmarrje që ka një dobi shoqërore të pazëvendësueshme, madje mund të them se nga pikëpamja e infrastrukturave teknologjike e ka ndjekur më mirë se çdo sektor tjetër progresin në botë.

Numerizimi i teknologjisë në studiot televizive dhe më gjerë, HD, kalimi në ueb, përhapja e sinjalit televiziv edhe me rrjete kabllore, mpleksja e transmetimeve tokësore me ato satelitore, etj., mund të na bëjë të pohojmë se sektorët e tjerë janë shumë pas.

Cilët prej tyre janë në këtë nivel bashkëkohësie: bujqësia, tregtia me pakicë, nxjerrja e mineraleve, peshkimi, rrjeti bankar, cilët pra?

Pa fund kritika mund t'i bëhen sistemit të informimit publik, por megjithatë ajo që është kryesorja, një tonalitet kritikë ndaj qeverisjes, media e ka përcjellë dhe ky është një nga treguesit më të rëndësishëm.

Po ashtu, edhe në disa raste kemi produkte spektakli që herë pas here asnjë institucion tjetër kulturor nuk i përballon. Ku janë teatrot, varietetet, opera, etj.?

Po ashtu edhe reklamën audiovizive, një nga përmasat e industrisë së medias, nuk mund të themi se e kemi të munguar.

*Nuk dëshiroj të pikturoj me ngjyra rozë peizazhin mediatic, sepse problemet janë gjithashtu të mëdha. Por, njëherë ja vlen të tregohet se edhe arritje ka.*

Po të ishte për një analizë kritike, pikëpamja ime është se në komunikimin masiv ka dy anë, industria e medias dhe gazetaria me gazetarët.

Unë mendoj se nëse do të flasim për një krizë të komunikimit masiv, sipas meje, ajo krijohet nga industria e medias e cila infektion gazetarinë, dhe nuk gjenerohet nga gazetaria për të infektuar industrinë e medias.

Ky dallim duhet bërë qartë. Brenda industrisë së medias ka elemente që duhen dalluar prej njëri-tjetrit. Ka elemente teknologjike, menaxheriale dhe financiare.



Nga këto të treja ajo që prodhon krizën është formula financiare dhe jo dy të tjerat që janë pasoja.

Mediat audiovizive shqiptare vuajnë pikërisht nga mospasja e një formule financiare të saktë, në kushtet e bollëkut të informacionit, që si çdo bollëk, në kushtet e shkuarjes të vlerës së 'mallit informacion' drejt zeros, dhe rritjes stratosferike të kostos së prodhimit të informacionit cilësor, e nxjerr jashtë loje ekonominë e medias nëse kjo nuk transformohet nga pikëpamja e modeleve ekonomike.



Mediat audiovizive shqiptare financohen shumë pak nga publiku, gjithnjë e më pak mjaftueshëm nga reklamat, pothuajse asfarë nga mbështetjet financiare të pushtetit publik, dhe në këto kushte duke pasur burime financiare që vijnë ndoshta nga sektorë të tjerë të kompanive apo bizneseve, etj., sigurisht njohin mungesë financiare dhe të gjitha pasojat e saj.

Dhe në këto kushte ndodh edhe 'kioskëzimi' i medias audiovizive, e cila nuk e njuh falimentin por thërrmohet në një numër gjithnjë e më të madh burimesh sinjali.

*Për mua, ka vend të mendohet fort për formulën financiare si nga ana e menaxherëve ashtu edhe e rregullatorëve, si dhe të funksionojë ekonomia e medias sipas kriterëve bazë të saj: rendimentin financiar, përqendrimin në një masë të caktuar pa prishur pluralitetin, burimet e shëndosha financiare për median, të dala përbrenda sektorit, si edhe rregullat e falimentit.*

Kam dëgjuar një botues gazete që krenohej se nxirrte një gazetë ndonëse me humbje, dhe jam lemerisur sesa pak di ai nga ekonomia e medias.

## **2. Ai ndiqni sot programet radio-televizive dhe cilat janë pritshmëritë tuaja mbi cilësinë e programeve tani që transmetimet do të kalojnë në numerike?**

Unë kam tre mënyra që ndjek programet audiovizive. E para, për qëllime studimore. Pra, këtu ndjek edhe media cilësore, por edhe programe televizive të dobëta, sepse këto të fundit japin më shumë shanse për të kuptuar se çfarë ndodh dhe çfarë funksionon jo mirë në ato që kanalet televizive na paraqesin në front office-t e

tyre, pra në ekranet tona. Përgjithësisht ndjek emisionet televizive që nuk më pëlqejnë ose ato që as më ngrohin e as më ftohin.

Së dyti, ndjek emisionet prime time me natyrë debati politik, por me porcione, pesë minuta këtu, dhjetë minuta atje. Thjesht për të parë se kush është kushi, dhe njohur cilësinë e komunikimit politik te ne. Ajo është dramatikisht e ulët. Ne akoma jemi te lideri politik drejtues mitingjesh dhe ende nuk kemi liderin politik menaxher, jurist, administrator.

Së treti, ndjek emisionet humoristike, ta zëmë Portokalli, Al Pazar, e ndonjë tjetër. Vetëm këto shoh për qejfin tim. Pjesa tjetër për arsye profesionale.

Problemet me cilësinë, pa fund. Por, po t'i përmbledh do të thosha se ne ende e përdorim televizionin sikurse të ishte radio ose gazetë; të mbyt teksti; kemi shumë pak gazetarë të imazhit; televizioni është linear me një programacion të ngurtë, duket sikur është tren me qymyr që tërheq 24 vagona për t'i ngjitur në Dajt; i ngadaltë deri në mërzi; diversiteti i lajmit dhe struktura e tij është për të ardhur keq; emisionet prime time nga ato me kosto krejt të ulët; një luftë për audiencë të shtyrë drejt banalizimit të përmbajtjes, etj.

Televizioni linear me programacion të ngurtë, sipas të dhënave sociologjike që Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit i Universitetit Publik të Tiranës disponon, është sot "televizioni i të varfërve", pra i shtresave që kanë pak mundësi për ta ndjekur financiarisht informacionin në platformat e reja numerike. Si i tillë ai është marginalizuar në audiencë dhe kjo është një këmbanë alarmi për menaxherët dhe drejtuesit. Po

që se nuk e dëgjojnë shumë shpejt do ta kuptojnë sesa gabim kanë bërë që nuk janë transformuar.

Transformimi, "disrupture", nuk bëhet në pikën më të ulët të evoluimit, por në kuota të larta, përndryshe...

## **3. Institucionet kryesore të ngarkuara për kalimin e transmetimeve nga analoge në numerike janë në këto momente duke punuar fort që procesi në vendin tonë të nisë dhe vazhdojë me sukses. Cili është mendimi juaj për këtë?**

Ashtu qoftë, i uroj për këtë. Por, unë mendoj, nisur edhe nga kontakti me ekspertë europianë të tranzicionit drejt transmetimeve numerike tokësore, se ka edhe probleme modelore dhe strukturore që është mirë të mbahen parasysh.

AMA ka vend të ketë atë status të anëtarëve të vet që ka në Europë për homologët e saj.

Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Publik zgjidhet në atë mënyrë që e mban atë varur nga politika dhe nga "mediat gastronomike"; dhënia për administrim këtij radiotelevizioni një rrjeti të dytë transmetimesh ku u propozohen të futen operatorët televizivë lokalë, është sipas meje jologjike dhe madje e papranueshme nga këta të fundit;

metoda e nxjerrjes së buxhetit me anë të taksës televizive krejt arbitrare është e kaluar nga koha;

po ashtu është me rëndësi që operatorët televizivë privatë ta kuptojnë se nuk ka arsye të ndërtojnë rrjete më vete, por një rrjet të përbashkët që ka shumë më pak shpenzime. Futja e operatorëve lokalë

në një rrjet më vete nuk përputhet me kërkesën e publikut për ta pasur në një rrjet të vetëm edhe Radiotelevizionin Publik, edhe televizionet komerciale kombëtare, edhe ndonjë televizion informativ, edhe operatorët lokalë të zonës së tyre.

## **4. Ç'mund të thoni për konferencën mbi digjitalizimin që u zhvillua më 25 nëntor si një bashkëpunim i Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit dhe Autoritetit të Mediave audiovizive?**



AMA, drejtuar nga z. Gentian Sala, dha shembullin se e ka kuptuar që Shqipëria përparon kur ka konvergencë midis energjive të shtresës menaxheriale me shtresën e studiuësve.

Dua të them se u dëshmuar që ne kemi potencialin mendor dhe menaxherial të niveleve europiane dhe perëndimore kur është fjala në rrafshin konceptual.

Nuk është pak sepse quhet "stoku i dijeve". Mbi të gjitha Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin Publik



të Tiranës ka mijëra faqe studime, mijëra të dhëna sociologjike, një pasuri të madhe bibliotekare, etj., që i jep mundësi një bashkësi studiuesish prej rreth pesëdhjetë individësh ta monitorojnë profesionalisht industrinë e medias, të vendosin pikat mbi plagët, të japin propozime si edhe të kthehen në menaxherë publikë shumë të mirë.

*Po kush i pyet se!!!*

*Edhe shkollën doktores, fidanishten e këtij hopi të madh, na e kanë bllokuar.*

*Çfarë të them?*

*Që dikujt nuk i intereson që Shqipëria të ketë mendim intelektual!!!*

*Këtë të them?*

*Por, nuk ma nxë goja, sepse do të ishte fjala e fundit.*

##### **5. Në kushtet që jemi, çfarë mund të bëjnë aktorët për të ndikuar për mirë, dmth. të rrisin cilësinë e programacionit dhe të ndikojnë në pjekjen e audiencës?**

Të heqin dorë nga mbipopullimi i modelit të televizionit gjeneralist, linear, me informacion kryesor atë politik, të lajmeve kombëtare.

Kjo media audiovizive është e “dalë boje” tashmë. Secili nga operatorët duhet të përqendrohet atje ku ka pikën më të fortë dhe mos hapërdahet me investime gjithandej.

##### **6. Si e shihni ju të ardhmen e televizionit dhe radios në Shqipëri? Cili është lloji i televizionit që ju do të dëshironit të promovonit?**

Kjo lidhet edhe me pyetjen pararendëse. Duhet kuptuar se jemi në situatën “multiscreen” dhe do të jemi gjithmonë

e më shumë në këto kushte. Audiencia gjithmonë e më shumë e merr sinjalin televiziv nga ekrane të ndryshme ku ai i televizionit është më klasiku dhe po humb gjithnjë e më shumë terren.

Platforma mobile, telefonike, ose të internetit “wideband”, po kërkohen gjithnjë e më shumë nga audiencia. Kompani të fuqishme planetare po ofrojnë në ueb gjithnjë e më shumë OTT (“over the top”), domethënë video me përmbajtje të larmishme dhe nesër mund t’i kemi të përshtatura edhe për audiencat shqiptare.

Konkurrenca është bërë planetare, e kotë të kërkosh të mbijetosh jo me performancë, por me monopole të përkohshme të natyrave nga më të ndryshme.

Po ashtu, kemi edhe kalimin drejt te audiencia të përmbajtjeve televizive nga kompanitë producente nëpërmjet transmetimeve mobile të sinjalit televiziv drejt ekraneve mobile.

Sigurisht televizioni linear numerik do të ketë rolin e tij, por të kufizuar. Ai do të konkurrohet nga televizionet lokale me kablo dhe nga përmbajtjet planetare ose të distancave të shkurtra në ueb.

Televizioni linear numerik do të mbetet vetëm për disa lloj audiencash, për të ruajtur disa ngjyresa kombëtare të informacionit dhe kulturës, dhe si një mekanizëm për të krijuar një lloj uniteti të opinionit publik;

po ashtu edhe për shtresa që duan një përmbajtje më të lirë, për rrjedhojë më pak cilësore. Ai mbijeton nga ajo që quhet “digital device”.

*Sa për mua, unë nuk mund të pranoj që të ndjek televizionin që më përcakton kohën time, që më komandon vëmendjen time, që më lodh e më mërzit me ngadalësinë e vet, që më jep një informacion politik banal dhe mediokër, më shumë në formë mitesh e barcaletash parlamentare. Këto janë forma manipulimi.*

Unë parapëlqej atë që quhet “self mass communication”, i cili më lejon që nga bota e mesazheve të zgjedh atë që dua, kur dua, dhe si e dua.

Unë edhe lajmin shkencor dhe politik sot e marr nga twitter, filmin nga Netflix, emisionet televizive nga Youtube, edhe Portokallinë madje andej e marr, të tjerat, si të më vijë...





# HISTORIKU I KRIJIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË AMA-S

## RETROSPEKTIVË

Historiku i AMA-s nuk është historiku i fillimit të medias elektronike në Shqipëri, edhe pse është lidhur ngushtë me veprimtarinë e medias.

Historia e krijimit dhe zhvillimit të veprimtarisë institucionale të AMA-s, ish-Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT), është e lidhur ngushtë me ndryshimet demokratike në Shqipëri pas viteve '90. Njëherësh, themelimi i këtij institucioni ishte kërkesë e domosdoshme e zhvillimeve politike, sociale, kulturore e mediatike që përjetonte shoqëria shqiptare e kohës.

Por, nga ana tjetër transmetimet e para radiotelevizive private, ishin pothuajse të gjitha të jashtëligjshme, pasi mungonte krejtësisht hapësira ligjore dhe zhvillimet ishin shumë të shpejta.



Transmetimet e para të medias elektronike private datojnë në vitin 1995, me “Telenorbën” shqiptare, programet e së cilës transmetoheshin nga Italia. Televizioni i parë privat në Shqipëri është “Shijak TV” që nisi transmetimet në dhjetor të vitit 1995. Po në këtë vit nisi transmetimet edhe radioja e parë private, Radio Vlora. Më pas, në vitin 1996 e në vijim, filluan transmetimet e disa televizioneve lokale “TV Antena Jug”, Gjirokastër; “Alba TV”, Tiranë; “TV Lezha”, Lezhë; TVA, (Tele Arbëria) Tiranë; TV Rozafa, Shkodër.

Fillimet e transmetimeve radiofonike në Shqipëri zënë fill me Radio Tiranën më 28 nëntor 1938, vijojnë me Televizionin Shqiptar në vitin 1960 e me radiot filiale të RTSH-së, si: Radio Shkodra, Radio Gjirokastra, Radio Kukësi e Radio Korça, por evoluimi i mirëfilltë i transmetimeve radiotelevizive shqiptare ndodhi pas viteve '90, falë konkurrencës së lirë dhe iniciativës private.

Me gjithë fillimet e vështira, mungesat e teknologjisë, infrastrukturës, personelit të kualifikuar, etj., si dhe mungesën e legjislacionit përkatës, për dy vjet Shqipëria numëronte afro 30 transmetues radiotelevizivë, të palicencuar, edhe pse ndërkohë, ishte miratuar një ligj për veprimtarinë audiovizive, i cili asnjëherë nuk u zbatua, as pjesërisht.



Veçantia e zhvillimit të veprimtarisë së një organi mbikëqyrës e rregullator qëndron në fillin e hollë që ndan respektimin e lirisë së shprehjes me anë të mjeteve audiovizive me respektimin e lirisë së individit, respektimin e privatësisë dhe lirive të tjera themelore; lirinë në përzgjedhjen e programeve në bazë të parimit të pavarësisë editoriale,

**KKRT**  
Keshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

si dhe lirinë në përzgjedhjen nga ana e individëve e programeve të dëshiruara. Në këtë rast roli i organit rregullator bëhet i domosdoshëm, këtu nis e konsolidohet edhe funksionimi i ish KKRT-së, sot AMA.

Jo rrallë, veprimtaria e këtij institucioni si dhe përmbushja e detyrimeve parësore të tij është bllokuar për shkak të qëndrimeve e interesave politike të shumicave apo pakicave parlamentare, qoftë për qëndrime të vetë ish KKRT-së, të ndikuara nga interesa politike. Nevoja për ndryshimin e legjislacionit në fushën e transmetimeve



audiovizive lindi si rezultat i zhvillimeve të vetë shërbimeve të medias elektronike, zhvillimeve teknologjike në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shoqërisë së informacionit si dhe për të përmbushur detyrimet që ka Republika e Shqipërisë për të harmonizuar legjislacionin e saj në këtë fushë me legjislacionin evropian.

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, është hartuar në përputhje të plotë me Direktivën AVMSD (Direktiva për Shërbimet e Medias Audiovizive). Ky ligj, veç të tjerash, garanton pavarësinë e institucionit, rrit efikasitetin e veprimtarisë e të kryerjes së funksioneve themelore, përcakton parime, dispozita e kriteret përfaqësues për transmetimet audiovizive dhe mbron interesat e publikut ndaj “rrezikut mediatic”.

Në situatën aktuale, AMA e ushtron veprimtarinë e vet mbikëqyrëse e kontrolluese për 72 subjekte audiovizive, 71 subjekte audio, 114 subjekte ripërsëritëse audiovizive kabllore si dhe 12 OSHMA satelitor/online/internet.

Rikonstituimi i AMA-s, në nëntor 2014 nxit investimin e frymës së partneritetit me transmetuesit audio dhe audiovizivë, për zbatimin rigoroz të ligjit, rritjen e cilësisë së programeve e të transmetimeve audiovizive, përshtetimin e procesit të digjitalizimit. Është rritur ndjeshëm transparencja e mbledhjeve të AMA-s, është përmirësuar performanca e punonjësve të administratës dhe situata financiare e institucionit si dhe janë intensifikuar takimet me faktorin ndërkombëtar, si: BE, KiE e OSBE, për të krijuar një tjetër klimë bashkëpunimi, një shkëmbim efikas përvojë me Autoritetet Rregullatore të vendeve të rajonit e të BE-së.

AMA ka përcaktuar objektiva dhe detyra konkrete për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me procesin e digjitalizimit dhe forcimin e pavarësisë së Autoritetit rregullator në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave me të cilat e ngarkon ligji.

Përgatiti: **Zimo KRUTAJ**  
Ekspert në Drejtorinë e Programeve



...duke punuar për numrin e radhës... ..







**Adresa:** Rruga "Abdi Toptani", Tiranë, 1001.

**Tel:** +355 4 222 6288 **Cel:** +355 66 20 44 909

**e-mail:** [Info@ama.gov.al](mailto:Info@ama.gov.al)

**[www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)**